



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:041531
Datë: 26.02.2024
Numri i dokumentit: 05374043

AA.nr.516/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit H.N nga Komuna Kamenicës, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale – Divizioni per Ndhma Sociale në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.491/2021 të datës 16.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit H.N nga Komuna Kamenicës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.491/2021 i datës 16.05.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.491/2021 të datës 16.05.2023, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit H.N nga Komuna Kamenicës, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të

paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Ndhimave Sociale, i dt. 08.01.2021.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar akovat Shefqet Rexha nga Kamenica, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, ashtu siç rrjedh nga përmbajtja e ankesës. Me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të prishët dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë ose të ndryshohet, ashtu që të aprovohet padia dhe kërkesëpadija e paditësit si i bazuar.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Ndhimave Sociale, në Prishtinë, me vendimin me Nr.prot.495 të dt. 08.01.2021, e ka refuzuar ankesën nr.15224 të dt.21.08.2020 të H.N i lindur me ... me nr personal... Komuna Kamenices. Refuzimi i kërkesës për asistencë mujore në vlerë prej 130.00euro sipas pikës 1 të këtij vendimi është për muajin 05-2020. Mbetet në fuqi aktvendimi nr 84245 i dt.16.07.2020 i Qendres për Punë Sociale QPS-Kamenice.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Ndhimave Sociale në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 02.03.2021, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pasi vlerësoi aktvendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, si dhe dokumentacionit dhe shkresave tjera të lëndës bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Me arsyetim se gjykata, për të vlerësuar ligjshmërinë e aktit të

kontestuar me padi për përfitim të asistencës mujore sipas Masës 15 e Pakos Emergjente Fiskale, ju referua Vendimit nr.35/2020 datë 16.04.2020 pika dy ku përcaktohet e drejta e përfitimit në pagesë të asistencës mujore në vlerë prej 130 njëqind e tridhjetë euro për periudhën prill-qershor 2020 , familjet të cilat nuk kanë asnjë të punësuar (sektori publik dhe privat), nuk pranojnë asnjë pagesë mujore nga buxheti i Republikës së Kosovës (pension apo asistencë tjetër sociale), janë të lajmëruar si të papunë në institucionin kompetent dhe që janë banorë rezident në Republikën e Kosovës, si dhe pika III e vendimit përcakton obligimin të jetë i regjistruar i papunë në Zyrën e Punësimit. Nga provat e administruara, gjykata e shkallës së parë konstaton se në bazë të dhënave elektronike lëshuar nga Agjensioni i Regjistrimit Civil, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Skemat tjera Pensionale është vërtetuar se paditësi nuk ka lajmëruar te atin B.N i cili realizon pensionin bazë të moshës në formularin D1 për aplikim për përfitim nga Masa nr. 15 andaj një konstatim i tillë i mbështetur me provat siç janë raporti verifikimit numër 16842 për periudhën e verifikimit, raporti i verifikimit 140934 për periudhën e verifikimit dhe raporti i verifikimit 78888. Nga këto prova të mbështetura, e bën të pabazuar pretendimin e paditësit lidhur me përfitimin nga masa 15, për faktin se bie në kundërshtim me vendimin nr.35/2020 datë 16.04.2020 pika dy ku përcaktohet “ *e drejta e përfitimit në pagesë të asistencës mujore në vlerë prej njëqind e tridhjetë euro për periudhën prill-qershor 2020 , familjet të cilat nuk kanë asnjë të punësuar (sektori publik dhe privat), nuk pranojnë asnjë pagesë mujore nga buxheti i Republikës së Kosovës* ”. Mbi këtë gjendje të fakteve, gjykata e shkallës së parë konstaton se në këtë çështje administrative drejt është vërtetuar gjendja faktike, se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, prandaj nuk i aprovoi pretendimet e ngritura nga ana e paditësit, sepse i vlerësoi të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organeve administrative.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjukata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktgjykimit të ankimuar nuk ka bere vlerësim objektiv dhe ligjor dhe te paanshëm te provave e as krahasim dhe analizim te tyre, se ekziston mos pajtim dhe diskrepanc totale midis dokumenteve me shkrim ne njëren ane dhe asaj qe thuhet ne pjesën arsytues te aktgjykimit, ky pretendim nuk qëndron, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se paditësi i ka plotësuar kushtet duke qene se jeton ne kushte te vështira ekonomike dhe se është i papune dhe jeton vetëm me gruan dhe 3 fëmije te tij gjykata e shkalles se pare i ka injoruar tërësisht këto prova me vete faktin se ne arsyetim te aktgjykimit cek se ” është vertetuar se paditesi nuk ka lajmeruar te atin i cili realizon pension në bazë të moshes ne formalarin D1”kjo me te vertet është papergjegjesi kur dihet fakti se paditesi nuk jeton me prindin e tij pasi qe paditesi ka edhe 3 vellezer te tjere qe jetojne te ndare nga paditesi dhe prindi i tij jeton me vllaun e jo me paditesin. Kjo deshmohe me fakte/ prova sic është deklarata per bashkesin familjare e leshuar me dr.08.05.2023 ne Kamanice nr.ser. F 11531273 ku qarte shihet se prindi nuk jeton me paditesin prandaj konsiderojme se vendimi i te paditures eshte i pabazuar ne ligj respektivisht mbeshtetet ne gjendje faktike jo te vertetuar plotesisht dhe drejte ashtu sic ka gabuar edhe gjykata e shkalles se pare. Ky kolegji këto pretendime ankimore nuk i aprovoj, për faktin se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pabazuara, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe gjykata e shkallës së parë dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ i të paditurës dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë janë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Nga provat e administruara rezulton se gjykata e shkallës së parë në procedurën gjyqësore pas vlerësimit dhe analizimit të shkresave të lëndës si vendimit kontestues 08.01.2021, formularit të ankesës 08.01.2021, shkresës se datës 31.01.2023, vendimit të dt.03.04.2020, vendimit të dt.16.04.2020, ankesës se dt.21.02.2020, vendimit të dt.20.05.2020, dëftesës mbi pranimin e kërkesës për asistencë mujore, pasqyrës se pagesave, raportit të verifikimit datë 04.2020,

vërtetimit për papunësi, dhe deklaratës për bashkësi familjare, ankesës se datës 21.08.2020, deklaratës te papunësisë të datës 28.02.2023, deklaratës se bashkësisë familjare të datës 28.03.2023, me të drejtë ka konstatuar se vendimi i organit administrativ i të paditurës është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Prandaj, nga këto arsye kolegji i kësaj gjykate vlerëson se vendimi i kontestuar është i drejtë dhe i bazuar në ligj, se ka mbështetje në provat e administruara, si dhe janë dhënë arsye të mjaftueshme nga gjykata e shkallës së parë, të cilat arsye edhe kolegji i kësaj gjykate i pranon.

Ndërsa sa i përket pretendimeve tjera ankimore të paditësit se aktgjykimi i ankimuar është në kundërshtim me arsyetimin dhe se nuk përmban arsyet mbi faktet relevante për gjykim te drejte e te plote te çështjes juridiko-administrative, kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, pasi të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të konstatuar nga organet administrative dhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar se organet administrative drejtë kanë zbatuar dispozitat ligjore. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë dhe se edhe e drejta materiale, është aplikuar drejtë se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr.516/2023, me datë 14.02.2024

Kryetari i kolegjit

Ramiz Kuqi